

Kosovo Property Claims Commission
Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës
Komisija za imovinske zahteve Kosova

Perandori Justinian 5
Pristina
Tel: +381 (0) 38 249-918
Fax: +381 (0) 38 249-919
E-mail: mailbox@kpaonline.org

VENDIM

PANELI NR:1

NR I VENDIMIT: KPCC/D/A/102/2011
DATA E VENDIMIT: 23/02/2011

Komisionerët Heiskanen (Kryetar),
Vokshi dhe Wühler

URDHËR

Në secilën prej 121 (njëqind e njëzet e një) kërkesave të identifikuar në pjesët A, B, C, D, E, F dhe G të listës së bashkangjitur, Komisioni vendos që kërkesat të hidhen poshtë.

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës ("Kuvendi") ka miratuar Ligjin Nr. 03/L-079 duke miratuar dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 ("UNMIK/REG/2006/50") mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") i cili miraton dhe ndryshon Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut Nr. 2007/5 ("UNMIK/ADM/DIR/2007/5"), e cila zbaton Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50. Me Ligjin Nr. 03/L-079 dhe Aneksin I themelohet Agjencia Kosovare e Pronës ("KPA") si agjenci e pavarur, dhe ndryshohen dispozitat përkatëse të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me dispozitat e tyre, Ligji Nr. 03/L-079 dhe Aneksi i kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare.

2. Sipas nenit 22 të Rregullosës të UNMIK-ut 2006/50, Rregullorja pushon së aplikuari me datën 31 dhjetor 2008. Prandaj, Ligji Nr. 03/L-079 është aktualisht burimi i vetëm i autoritetit ligjor të Komisionit. Dispozitat e Rregullosës së UNMIK-ut 2006/50 vazhdojnë të mbesin relevante vetëm ashtu siç janë inkorporuar sipas Ligjit Nr. 03/L-079.

ARSYET PËR VENDIM

3. Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposedim të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejta të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshin rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullosës së UNMIK-ut 2006/50 i miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)

4. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullosës së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia dhe paraqitësi i kërkesës nuk e dëshmon të kundërtën, të nxjerrë urdhër për riposedim në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullosës së UNMIK-ut 2006/50 të miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin

3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhërësës Administrative nr. 2007/5, e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)¹

5. Komisioni mbajti seancën e njëzet e një të nga 21 deri më 23 shkurt 2011 në Prishtinë. Gjithsej 2,632 kërkesa bujqësore i janë paraqitur Komisionit në seancën e njëzetë e një të, nga Sekretaria Ekzekutive e KPA-së ("Sekretaria Ekzekutive"), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata tjera relevante. Megjithatë, dy nga kërkesat bujqësore të paraqitura në Komision u rikategorizuan nga Komisioni gjatë seancës si kërkesa banesore dhe rrjedhimisht përfshihen në vendimet që kanë të bëjnë me pronat banesore. Një kërkesë tjetër bujqësore që i ishte paraqitur Komisionit nga Sekretaria Ekzekutive në seancën e trembëdhjetë të Komisionit, por në të cilën Komisioni e ndërpreu vendimmarrjen në pritje të konfirmimit të notifikimit fizik të kërkesave për pronat e kërkuara i është paraqitur Komisionit, por u tërhoq nga Sekretaria Ekzekutive gjatë seancës. Gjithsej, 2,631 kërkesa bujqësore u shqyrtuan nga Komisioni gjatë seancës së njëzet e një të.

6. Në seancën e njëzetë e një të të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe i ka raportuar mbi përpunimin e kërkesave, dhe çështjet ligjore dhe dëshmuese të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

A. Kërkesa të përfshira në këtë vendim.

7. Në të gjitha kërkesat e përfshira në këtë vendim, paraqitësit e kërkesave kërkojnë zgjidhjen e kërkesës për pronësinë dhe që të gjitha kanë të bëjnë me pronat bujqësore, përfshirë arat, kullotat dhe pyjet.

8. Ky vendim përfshin gjithsej 121 (njëqind e njëzet e një) kërkesa, ashtu si janë përcaktuar në listën e bashkangjitur. Pjesa e mbetur prej 2,510 kërkesash për prona bujqësore të trajtuara nga Komisioni gjatë seancës përfshihen në tri vendime, pikërisht vendimet KPCC/D/A/100/2011, KPCC/D/AR/101/2011 dhe KPCC/D/AR/103/2011.

9. Me qëllim që të përmbushen kushtet e një kërkesë të vlefshme, paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, duhet të tregojë se ai ka pasur të drejtë pronësore në lidhje me pronën e kërkuar dhe se ai ose ajo nuk ka mundësi të ushtrojë të drejtën pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë ose rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë midis 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

10. Gjithsej 25 kërkesa të përfshira në këtë vendim, janë shqyrtuar më herët nga Komisioni, ndërsa 96 kërkesa i janë paraqitur Komisionit për herë të parë. Megjithatë, vendimi i

¹ Duket se ka një gabim teknik në Aneksin I. Ndonëse në mënyrë të qartë paraqitet që Aneksi i kishte për qëllim të zëvendësonte në tërësi Urdhërësën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, përfshirë që të tri Aneksit e saj, Neni 26 i Aneksit i parasheh që e drejta nga Aneksi III i Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 duhet të zëvendësohet me të drejtën e cila referohet në Aneksin II. Megjithatë, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë apo ndonjë të dhënë tjetër në Ligjin 03/L-079 apo në Aneksit e tij që qëllimi i këtij ndryshimi të veçantë ishte të heq Aneksin I apo Aneksin II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron që të tri Aneksit e Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 janë përfshirë në pakon legjislative dhe Komisioni do t'u referohet në këtë vendim si Nën-Aneksit I, II dhe III, respektivisht.

mëparshëm për këto kërkesa është shfuqizuar nga Komisioni ose për shkak të notifikimit të pasaktë të pronave të kërkuara gjatë përpunimit të kërkesave nga Sekretaria Ekzekutive, ose për shkak të gabimeve të tjera të përpunimit nga Sekretaria Ekzekutive të cilat janë zbuluar pasi vendimi ishte marrë. Për rrjedhojë, këto kërkesa duhet të rivendosen pas notifikimit të saktë të pronave të kërkuara dhe korrigjimit të gabimeve të tjera të përpunimit. Dëshmitë dhe informacioni i ofruar nga çdo palë përgjegjëse e kërkesës ose çdo uzurpues aktual i pronave merren në shqyrtim nga Komisioni në rivendosjen e kërkesave. Në lidhje me kërkesat, vendimet e mëparshme të të cilave janë shfuqizuar nga Komisioni, Sekretaria Ekzekutive i ka shkruar secilit paraqitës të kërkesave duke i informuar ata për gabimet e notifikimit dhe po ashtu i informon ata se kërkesat e tyre do të rivendosen pas notifikimit të saktë të pronave të kërkuara. Paraqitësit e kërkesave si dhe autoritetet kadastrale përkatëse janë informuar se vendimet e mëparshme të Komisionit janë pavlerë dhe nuk mund të përdoren për qëllimet e çfarëdo transaksioni ligjor.

11. Të gjitha kërkesat e përfshira në këtë vendim janë kontestuese në kuptimin se pala që ka uzurpuar pronën e kërkuar, ose pala që ka shprehur interes ligjor në prona të tilla ("pala përgjegjëse"), ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda periudhës prej 30 ditësh të parashikuar me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedimit në bazë të nenit 10.3 Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079. Vendimet që janë marrë për kërkesat, të cilat janë notifikuar gabimisht, janë shfuqizuar nga Komisioni për të siguruar notifikimin e saktë të pronave dhe për t'i ofruar çdo personi që ka interes ligjor në pronë, mundësinë për t'iu përgjigjur kërkesës në pajtim me nenin 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Këto kërkesa janë identifikuar në kolonat përkatëse në listën e këtij vendimi. Sekretaria Ekzekutive i ka notifikuar kërkesat në mënyra të ndryshme përfshirë edhe notifikimin fizik të pronave dhe/ose përmes notifikimit të pronave nëpërmjet publikimit në gazeta dhe gazeta zyrtare, përmes autoriteteve komunale vendore, gjykatave komunale, udhëheqësve vendore të fshatit dhe përmes institucioneve të tjera përkatëse në Kosovë dhe Serbi. Bazuar në informacionin e ofruar nga Sekretaria Ekzekutive, Komisioni është i kënaqur se Sekretaria Ekzekutive ka bërë përpjekje të arsyeshme për të notifikuar pronat e kërkuara, për të njoftuar personat të cilët aktualisht mundet t'i kenë uzurpuar pronat dhe cilindo person tjetër që mund të ketë interes ligjor në pronat e tilla, ashtu si e kërkon neni 10.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079.

12. Në bazë të nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, secilës prej palëve përgjegjëse u është dhënë nga një kopje e kërkesës të dorëzuara nga paraqitësi përkatës i kërkesës. Në bazë të nenit 3.5 të Aneksit II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079, paraqitësve të kërkesave u është dhënë një kopje e dokumenteve të paraqitura nga secila palë përgjegjëse në përgjigje të kërkesës. Të dy palëve, në secilin rast u është dhënë kështu mundësia të komentojnë për informacionin e siguruar nga pala tjetër dhe komentet ose informacionet e tilla janë marrë në konsiderate gjatë përpunimit edhe vendosjes së kërkesës. Komisioni vëren se pala e parë përgjegjëse në kërkesat e përfshira në pjesët D dhe E të listës së bashkangjitur këtij vendimi refuzoi të pranojë një kopje të dokumenteve nga paraqitësit e parë edhe të dytë në këto kërkesa.

B. Kërkesa të hedhura poshtë.

13. Në bazë të nenit 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079 Komisioni hedh poshtë të gjithë ose një pjesë të kërkesës kur:

- (a) Paraqitësi i kërkesës ka dështuar të depozitojë kërkesë në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë rregullore;
- (b) Kërkesa nuk është në fushëveprimin e juridiksionit të Agjencisë Kosovare të Pronave;
- (c) Kërkesa është shqyrtuar edhe vendosur më parë në një vendim administrativ ose gjyqësor të formë së prerë.

14. Neni 8.6 i Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-07907/50 i jep Komisionit kompetencat të refuzojë ose hedhë poshtë një kërkesë në çfarëdo baze duke përfshirë edhe ato të përcaktuara me nenin 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

15. Kërkesat të cilat janë hedhur poshtë për shkak se bien jashtë juridiksionit të Komisionit ose për arsye procedurale dhe jo për shkak të meritave të kërkesës, mund të vendosen në gjykatat vendore në bazë të ligjit në fuqi. Në vendime të tilla vendimi i Komisionit nuk është *res judicata*. Neni 3.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079 konfirmon të drejtën e paraqitësve të kërkesave që të ndjekin kërkesat që nuk bien në mandatin e Komisionit para gjykatave me kompetencë juridiksionale ashtu si përcaktohet në nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. (Shih gjithashtu nenin 8.1 të Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 në lidhje me kompetencat e Komisionit për të referuar çështjet që lindin në lidhje me kërkesat të cilat nuk janë nën juridiksionin e tij një gjykatë vendore ose një bordi administrativ apo tribunalit).

16. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, juridiksioni i Komisionit është i kufizuar në kërkesat pronësore që ndërlidhen me konfliktin në kuptimin që përfshijnë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, ku paraqitësi i kërkesës tani nuk mund ta ushtrojë këtë të drejtë pronësore. Për të vërtetuar se a është kërkesa brenda juridiksionit të tij apo jo, Komisioni duhet të përcaktojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, është zhvendosur nga prona e kërkuar, ose nëse e ka humbur posedimin apo kontrollin mbi pronën e tillë, si pasojë e konfliktit. Komisioni gjithashtu duhet të vërtetojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, mund të ushtrojë të drejtën e tij/saj mbi pronën e kërkuar.

17. Ndonëse Komisioni ka pikëpamjen se humbja e posedimit që ka ndodhur përtej periudhës 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999 megjithatë mund të konsiderohet që ndërlidhet drejtpërsëdrejti me, apo që është pasojë e konfliktit, varësisht nga rrethanat e rastit, ai duhet të konstatojë se ka disa dëshmi që tregojnë se humbja e posedimit përfshin rrethanat që janë pasojë e konfliktit.

1. *Kërkesat nr. 15536 dhe 15537.*

18. Kërkesat nr. 15536 dhe 15537, ashtu si janë identifikuar në pjesën A të listës së bashkangjitur këtij vendimi, janë depozituar nga Darinka Mugos Novovic (“paraqitësi i kërkesës”) në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Vajza e paraqitëses së kërkesës e ka informuar tashmë Sekretarinë Ekzekutive se nëna e saj ka vdekur, por nuk është ofruar certifikata e vdekjes për ta dëshmuar këtë fakt. Komisioni konsideron se vdekja e paraqitësit të kërkesës gjatë procedurës nuk ndikon në vlefshmërinë e kërkesës. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësja e kërkesës ka dorëzuar fletën poseduese që e identifikon nënën e saj si pronare të ngastrës, si edhe një kopje të planit kadastral që e tregon paraqitësen e kërkesës si pronare të pronës bazuar në një vendim trashëgimie të vitit 1984. Paraqitësja e kërkesës ka deklaruar në formularin e pranimit të kërkesës se ajo ka humbur posedimin në qershor 1999 dhe se prona aktualisht është e uzurpuar nga një person i panjohur.

19. Komisioni vëren se këto dy kërkesa janë vendosur më parë nga Komisioni si kërkesa jokontestuese në vendimin e Komisionit KPCC/D/A/13/2008 datë 30 prill 2008. Në këtë kohë nuk pasur informacion në dispozicion të Komisionit ose Sekretarisë Ekzekutive për të treguar se ndonjë person e ka kundërshtuar kërkesën e paraqitësit të kërkesës. Me pas, Komisioni u informua se të dyja kërkesat ishin notifikuar në mënyrë të pasaktë, me fjalë të tjera, notifikimi fizik i pronave kishte ndodhur jashtë kufijve të ngastrës së kërkuar të tokës. Rrjedhimisht, Komisioni i shfuqizoi vendimet e tij të mëparshme në lidhje me këto kërkesa dhe udhëzoi që kërkesat të ripërpunohen. Informacioni dhe dëshmitë e reja që u vunë në dispozicion në rrjedhën e ripërpunimit të kërkesave nga Sekretaria Ekzekutive, përfshirë edhe dëshmitë edhe informacionin e ofruar nga palët përgjegjëse në këtë çështje, duhet të merren në konsiderate nga Komisioni.

20. Dy persona iu përgjigjen këtyre kërkesave, pikërisht Ymer Bardhi (“Pala e parë përgjegjëse”) dhe Ibish Kuqi (“Pala e dytë përgjegjëse”). Pala e parë përgjegjëse u paraqit në KPA në lidhje me këto dy kërkesa më 22 gusht 2008, ndërsa pala e dytë përgjegjëse u paraqit në KPA më 3 shtator 2008. Pala e dytë përgjegjëse deklaroi se babai i tij e kishte blerë pronën nga paraqitësja e kërkesës dhe bashkëshorti i saj në vitin 1979. Në mbështetje të mbrojtjes së tij, pala e dytë përgjegjëse ofroi procesverbalin e seancës gjyqësore në lidhje me transaksionin e pronës, megjithatë ky procesverbal ndërlidhet me një ngastër të veçantë, atë nr. 438/8. Pasi Sekretaria Ekzekutive sqaroi se kërkesat kishin të bënin me ngastrat nr. 111/dhe 111/2, dhe jo me ngastrën nr. 438/8, pala e dytë përgjegjëse deklaroi se ai nuk e konteston pronësinë e këtyre ngastrave, për të cilat ai deklaroi se ishin blerë shumë kohë më parë nga familja Bardhi. Pala e dytë përgjegjëse tregoi se ai dëshironte të tërhiqte përgjigjen ndaj këtyre kërkesave, por nuk ka paraqitur tërheqje me shkrim në Sekretarinë Ekzekutive.

21. Pala e parë përgjegjëse deklaroi se ai e ka blerë pronën e kërkuar në vitin 1978 dhe se ka qenë në posedim të pronës vazhdimisht që nga vitit 1976. Ai ofroi një deklaratë e cila thotë se çmimi i plotë i blerjes prej 70 milion dinarësh është paguar në kohën e blerjes në vitin 1978, por se paraqitësi i kërkesës e ka kundërshtuar më vonë çmimin e blerjes. Kontrata e blerjes nuk është regjistruar në Gjykatën Komunale të Pejës në kohën e blerjes, sepse prona ishte në emër të nënës së paraqitësit të kërkesës dhe procedura e trashëgimisë nuk ishte përfunduar deri në vitin 1984. Pala e parë përgjegjëse, më vonë, ndërmori veprim ligjor për të konfirmuar interesin e tij bashkëpronësor për ngastrën së bashku me dy vëllezërit e tij, Halil dhe Smajl Bardhi. Me anë të aktgjykimit të datës 27 shkurt 2006, gjykata konfirmoi interesin pronësor të palës së parë

përgjegjëse. Në mbështetje të përgjigjes së tij, pala e parë përgjegjëse ka dorëzuar një sërë dokumentesh duke përfshirë një aktgjykim të Gjykatës Komunale në Pejë nr. 2007/04 datë 27 shkurt 2006, fletën poseduese date 28 qershor 2007 e cila e tregon palën e parë përgjegjëse dhe dy vëllezërit e tij si bashkëpronarë të pronës, një kontratë me shkrim dore të datës 10 tetor (viti nuk mund të konfirmohet), midis bashkëshortit të paraqitëses së kërkesës, Milorad Novovic si shitës dhe Zhuj Keri Bardhaj, xhaxhai/daja i palës së parë përgjegjëse, si blerës dhe dhjetë fatura me shkrim dore që tregojnë se Milorad Novovic i ka marrë paratë nga Zhuj Keri Bardhaj. Sekretaria Ekzekutive e ka verifikuar aktgjykimin e gjykatës dhe fletën poseduese.

22. Më vonë, pala e parë përgjegjëse ofroi një numër të dokumenteve të tjera, përfshirë procesverbalin e datës 29 gusht 1984 e hartuar nga Lidhja Socialiste e Popullit Punonjës të Serbisë, një deklaratë të dhënë nga paraqitësja e kërkesës me 26 shtator 1986 në të cilën ajo pretendon se e ka shitur pronën nën kërcënimin e blerësit Zhuj Mahmut dhe shënimet zyrtarë të policisë të Kliqinës nr. 288/89 datë 12 mars 1989 të cilat konstatuan se kontrata nuk është nënshkruar nën kërcënim. Procesverbali i gushtit 1984 tregon se paraqitësja e kërkesës ka drejtuar një ankesë në komisionin vendor ku kërkonte ndihmë për të rimarrë tokën e saj pasi ajo e kishte shitur pronën disa vite më parë tek Zhuj Keri dhe Mahmut Keri më një çmim të ulët. Shënimet zyrtare të policisë së Kliqinës të marsit 1989 tregojnë se ankesa nuk është vërtetuar.

23. Kur Sekretaria Ekzekutive u përpoq të kontaktonte paraqitësin e kërkesës për të sqaruar rrethanat e shitjes së pronës, ajo u informua nga vajza e tyre se paraqitësja e kërkesës kishte vdekur. Vajza e paraqitëses së kërkesës e mohoi faktin që nëna e saj të kishte shitur ndonjë ngastër të tokës ndonjëherë dhe deklaroi se ajo dhe familja e saj nuk ishin lejuar nga familja Bardhi për të shfrytëzuar pronën.

24. U krye shkëmbimi i plotë i dokumenteve midis paraqitëses së kërkesës dhe palëve përgjegjëse, përfshirë një kopje të aktgjykimit të Gjykatës Komunale të Pejës të vitit 2006, e cila konfirmon pronësinë në emër të palës së parë përgjegjëse dhe dy vëllezërve të tij. Komisioni vëren se paraqitësi i kërkesës nuk është përfaqësuar në këtë procedure dhe se gjykata ka caktuar një përfaqësues të përkohshëm në emër të saj. Para caktimit të përfaqësuesit të përkohshëm, gjykata bëri përpjekje për të informuar për kërkesën paraqitësen e kërkesës brenda Kosovës përmes publikimit të një njoftimi në Gjykatë edhe publikimit të njoftimit në një gazete të përditshme në Kosovë; ajo bëri gjithashtu kërkesë në dy agjenci shtetërore për të siguruar informacionin e kontaktit për paraqitësen e kërkesës. Gjykata arriti në përfundimin se palët nuk e kanë nënshkruar kontratën e blerjes nën kërcënim, por në vullnetin e tyre të lire dhe konstatoi se pala e parë përgjegjëse ka qenë në posedim të pronës që nga viti 1976. Në zbatim të nenit 21 dhe 28 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike në lidhje parashkrimin fitues së pronës në mirëbesim, Gjykata konfirmoi të drejtën pronësore të palës së parë përgjegjëse edhe dy vëllezërve të tij. Komisioni vëren se kjo çështje gjyqësore u përfundua më 27 shkurt 2006, dmth., para hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50. Paraqitëses së kërkesës iu ofrua një kopje e aktgjykimit të gjykatës nga Sekretaria Ekzekutive edhe ajo nuk ka dhënë asnjë përgjigje.

25. Bazuar në dëshmitë në dispozicion përfshirë vendimin e Gjykatës Komunale të Pejës, datë 27 shkurt 2006, Komisioni konstaton se paraqitësja e kërkesës nuk ka humbur posedimin e pronës së kërkuar si rezultat i konfliktit të armatosur në Kosovë gjatë 1998-1999, por përmes shitjes e cila ndodhi në vitin 1978, shumë kohë para konfliktit. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të hidhet poshtë në bazë të nenit 11.4(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Komisioni, vëren gjithashtu se kërkesa është shqyrtuar e vendosur më parë me vendim gjyqësor të

formës së prerë, pikërisht me atë të Gjykatës Komunale të Pejës edhe për rrjedhojë duhet të hidhet poshtë gjithashtu si *res judicata* në bazë të nenit 11.4(c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. (Shih gjithashtu vendimin e mëparshëm të Komisionit në kërkesën e depozituar nga i njëjti paraqitës i kërkesave i cili e ka hedhur poshtë kërkesën për të njëjtat arsye, pikërisht vendimin KPCC/D/A/85/2010 datë 2 shtator 2010).

2. Kërkesa nr. 16011 dhe të tjerat.

26. Të njëmbëdhjetë kërkesat e identifikuar në pjesën B të listës së bashkangjitur këtij vendimi janë depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e tij si anëtar i bashkësisë familjare, i biri i bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore. Në mbështetje të kërkesës së tij, paraqitësi i kërkesës ka dorëzuar fletën poseduese në emër të nënës së tij të ndjerë si bartëse e së drejtës pronësore. Fleta poseduese është verifikuar *ex officio* nga Sekretaria Ekzekutive.

27. Sekretaria Ekzekutive ka notifikuar fizikisht pronat e kërkuara të cilat ndodhen në Komunën e Podujevës. Gjatë procesit të notifikimit të pronave, Z. Nazmi Fejza ("pala përgjegjëse"), i cili aktualisht shfrytëzon pronat e kërkuara, e kundërshtoi titullin e pronësisë të paraqitësit të kërkesës dhe kërkoi të drejtë ligjore për pronat. Ai pohon se bartësi i së drejtës pronësore i shiti pronat tek një palë e tretë në vitin 1970 dhe se familja e tij i kishte blerë pronat afërsish 10 vjet më vonë nga një palë, së cilës kjo pale e tretë ia kishte shitur pronën ndërkohë. Në mbështetje të pohimeve të tij, pala përgjegjëse ka dorëzuar një deklaratë dëshmitari si dëshmi për pagesën e taksave pronësore.

28. Fillimisht u pretendua se paraqitësi i kërkesës humbi posedimin e pronave si rezultat i konfliktit të 1998-1999, megjithatë, më vonë, paraqitësi i kërkesës informoi Sekretarinë Ekzekutive se familja e tij nuk kishte posedimin e pronave të kërkuara nga viti 1970 e më pas. Ai konfirmoi gjithashtu se nuk kishte as posedimin dhe as nuk i shfrytëzonte pronat e kërkuara në kohën e konfliktit të 1998-99 në Kosovë. Në këto rrethana, Komisioni konkludon se pretendimi për humbjen e posedimit nuk mund të thuhet se ndërlidhet me konfliktin. Rrjedhimisht, kërkesa e paraqitësit të kërkesës bie jashtë juridiksionit të Komisionit edhe duhet të hidhet poshtë.

3. Kërkesa nr. 20163 dhe të tjerat.

29. Shtatë kërkesat e identifikuar në pjesën C të listës së këtij vendimi janë depozituar nga Milenko Pajovic ("Paraqitësi i kërkesës") në cilësinë e tij të anëtarit të bashkësisë familjare, pikërisht djalit të bartësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës pohon se bartësi i së drejtës pronësore është babai i tij i ndjerë edhe ka dorëzuar një certifikatë vdekjeje si dëshmi. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka dorëzuar fletën poseduese që e tregon babain e tij si pronar të ngastrave të kërkuara. Ky dokument është verifikuar pozitivisht nga Sekretaria Ekzekutive. Paraqitësi i kërkesës deklaron se nëna e tij Sindja mbante posedimin e pronave të kërkuara deri në dhjetor 2004 kur ajo vdiq.

30. Pala përgjegjëse, Remzi Haradinaj, është paraqitur në Sekretarinë Ekzekutive në lidhje me ngastrat e kërkuara dhe kërkon të drejtë ligjore për pronat. Ai deklaron se e ka kultivuar tokën e kërkuar për më shumë se 20 vjet në bazë të një marrëveshje verbale me paraqitësin e kërkesës dhe nënën e tij. Ai deklaron se, me pas, ai e bleu pronën e kërkuar në vitin 2001. Në mbështetje të përgjigjes, paraqiti kontratën e blerjes të nënshkruar me 18 maj 2001 midis Sindja Pajovic, Biljana Pajovic-Mirjadic dhe Djurdje Pajovic si shitës dhe vetë palës përgjegjëse si

blerës. Kontrata nuk është vërtetuar nga gjykata e për rrjedhojë nuk mundi të verifikohet nga Sekretaria Ekzekutive. Pala përgjegjëse dorëzoi gjithashtu një deklaratë të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Vrsac, Serbi, datë 18 maj 2001, me anë të së cilës paraqitësi i kërkesës konfirmon së nënshkrimi që gjendet në kontratën e pavërtetuar të blerjes është nënshkrimi i tij. Ky dokument është verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive. Pala përgjegjëse pohon se ai nuk mundi të vërtetojë kontratën e blerjes pasi gjykatat vendore nuk funksiononin në vitin 2001. Kur ai u përpoq me vonë të vërtetojë kontratën, paraqitësi i kërkesës refuzoi të pranojë kontratën.

31. Paraqitësi i kërkesës mohoi faktin që ai ose ndonjë anëtar i familjes së tij të kenë shitur pronat e kërkuara tek pala përgjegjëse dhe pretendon se kontrata e blerjes është e falsifikuar. Ai pohon se kontrata e blerjes nuk mund të jetë e vërtetë pasi procedura e trashëgimisë në lidhje me babain e tij, bartësin e pretenduar të së drejtës pronësore, nuk ishte iniciuar në atë kohë dhe për rrjedhojë askush nuk ka pasur zotësinë ligjore për të shitur pronat e babait të tij.

32. Ndonëse paraqitësi i kërkesës dhe pala përgjegjëse kanë shpjegime të ndryshme për shfrytëzimin e pronave në të kaluarën, paraqitësi i kërkesës pohon se nena e tij ka mbajtur posedimin e pronave deri në dhjetor 2004, mjaft kohë pas përfundimit të konfliktit të armatosur në Kosovë. Sekretaria Ekzekutive kontaktoi paraqitësin e kërkesës për të sqaruar nëse kërkesa e paraqitësit të kërkesës përfshinte në ndonjë fare mënyrë rrethanat që ndërlidhen me konfliktin pas fillimisht u pretendua se posedimi i pronave kishte humbur në vitin 1999. Paraqitësi i kërkesës konfirmoi se nuk ka pasur humbje të posedimit për shkak të konfliktit të 1998-99, por pas vdekjes së nënës së tij në vitin 2004, pronat janë uzurpuar nga persona të panjohur. Si rrjedhim, kërkesat duhet të hidhen poshtë pasi bien jashtë juridiksionit të Komisionit.

4. *Kërkesa nr. 23154 dhe të tjerat dhe Kërkesa nr. 27389 dhe të tjerat.*

33. Të 38 kërkesat e identifikuar në pjesën D të listës të bashkangjitur këtij vendimi janë depozituar nga Marina Korac ("paraqitësja e kërkesës") në cilësinë e anëtarit të bashkësisë familjare, pikërisht mbesa e bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore, Dragoljub Stevic, ose si bartëse e së drejtës pronësore në të drejtën e saj, pasi ka trashëguar një pjesë të pronës së kërkuar nga gjyshi.

34. Shtatëmbëdhjetë kërkesat e identifikuar në pjesën E të listës së këtij vendimi janë depozituar nga Zoran Stevic ("paraqitësi i dytë i kërkesës") në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore pasi i ka trashëguar ngastrat e kërkuara në vitin 2004 nga babai i tij Bogomir Stevic. Dragoljub Stevic është gjyshi i paraqitësit të parë të kërkesës dhe xhaxhai/daja i paraqitësit të dytë të kërkesës. Pasi kërkesat e bëra nga paraqitësi i parë edhe i dytë i kërkesave ndërlidhen me të njëjtat rrethana faktike, ato trajtohen së bashku për qëllimet e këtij vendimi.

35. Në bazë të nenit 1.2 të Aneksit II të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079 kërkesat mund të depozitohen nga anëtari i bashkësisë familjare në emër të bartësit të së drejtës pronësore. Neni 1 i Urdhëresës Administrative, e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079 përcakton që si "Anëtar i Bashkësisë Familjare" përfshihen "bashkëshorti/ja, fëmijët (të lindur brenda dhe jashtë martesës ose të adoptuar) dhe personat tjerë të cilët bartësi i së drejtës pronësore është i obliguar t'i mbështesë në pajtim me ligjin e aplikueshëm apo personat që janë të obliguar ta mbështesin bartësin e së drejtës pronësore në pajtim me ligjin e aplikueshëm pavarësisht nëse ata persona kanë banuar apo jo në pronë të bashku me bartësin e së drejtës pronësore." Komisioni ka përcaktuar se, sipas ligjit të aplikueshëm, ky definicion

përfshin përveç bashkëshortëve dhe fëmijëve gjithashtu edhe prindërit, vëllezërit, motrat, gjyshërit, nipat/mbesat, stërgjyshërit dhe stërnipat/stërmbesat e bartësit të së drejtës pronësore. Rrjedhimisht, si mbesë e bartësit të së drejtës pronësore, paraqitësja e kërkesës ka zotësinë e kërkuar ligjore për të depozituar kërkesë në emër të gjyshit të saj të ndjerë. Paraqitësja e parë e kërkesës ka dorëzuar certifikatën e vdekjes të gjyshit, e cila përcakton datën e vdekjes si 25 nëntor 1991. Dokumenti është verifikuar si i vlefshëm nga Sekretaria Ekzekutive.

36. Të gjitha pronat e kërkuara nga paraqitësit e parë edhe të dytë të kërkesave ndodhen në Komunën e Podujevës dhe Sekretaria Ekzekutive i ka notifikuar fizikisht pronat e kërkuara. Gjatë procesit të notifikimit, dy persona, Sevdajet Sadriu ("pala e parë përgjegjëse") i cili aktualisht i shfrytëzon pronat e kërkuara dhe Musa Hoti ("pala e dytë") iu përgjigjën kërkesave. Pala e parë përgjegjëse iu përgjigj të gjitha kërkesave në emër të vëllait të tij, Bexhet Sadriu, i cili pretendon se i ka blerë pronat e aktualisht jeton në Gjermani. Pala e dytë përgjegjëse është përgjigjur vetëm për ngastrën e përfshirë në kërkesën nr. KPA47740, e cila kërkohej nga paraqitësi i parë i kërkesës. Pala e dytë përgjegjëse kërkon gjithashtu në emër të vëllait të tij, Isa Hoti, i cili pretendon ta ketë blerë ngastrën dhe jeton në Gjermani. Pala e parë përgjegjëse ka nënshkruar njoftimin e pjesëmarrjes duke kërkuar të drejtë ligjore për pronat, ndërsa pala e dytë përgjegjëse nuk ka nënshkruar njoftimin, por është përgjigjur me shkrim në të gjitha kërkesat. Pala e parë përgjegjëse ka dorëzuar prova të dokumentuara në mbështetje të përgjigjes së tij, por pala e dytë përgjegjëse nuk e ka bërë këtë. Komisioni është i kënaqur që pronat e kërkuara janë notifikuar si duhet në pajtim me nenin 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079.

37. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i parë i kërkesës ka dorëzuar një sërë dokumentesh që lidhen me të drejtën e pretenduar pronësore, pikërisht fletët poseduese nr. 7, 29 dhe 75 që e identifikojnë Dragoljub Stevic si pronar të pronave të kërkuara, dhe fletët poseduese me nr. 32, 96, dhe 121 që e identifikojnë Ratomir Stevic (vëllai i Dragoljub-it) si pronar të pronave të kërkuara. Paraqitësi i kërkesës ka dorëzuar gjithashtu dy vendime trashëgimie të lëshuara nga Gjykata Komunale e Podujevës të vitit 1984 dhe 1989, të cilat tregojnë se Dragoljub Stevic trashëgoi ½ e pronës që i takonte vëllait të tij Ratomir Stevic. Sekretaria Ekzekutive ka mundur të verifikojë të gjitha dokumentet e lartpërmendura kundrejt regjistrave kadastralë dhe regjistrave të mbajtura në Gjykatën Komunale të Podujevës. Paraqitësi i parë i kërkesës, ka dorëzuar gjithashtu një vendim trashëgimie të lëshuar nga gjykata paralele e Kursumli-së në Serbi sipas të cilit paraqitësi i parë i kërkesës ka trashëguar 1/10 e pronave të gjyshit të saj. Megjithatë, ky vendim trashëgimie nuk mund të konsiderohet si i vlefshëm pasi Dragoljub Stevic ka vdekur në Revuce në Podujevë dhe gjykata e Kursumli-së nuk ka kompetencën e kërkuar që të trajtojë procedurën e trashëgimisë.

38. Në mbështetje të kërkesës së tij, paraqitësi i dytë i kërkesës ka dorëzuar një vendim trashëgimie të lëshuar më 26 mars 2004 dhe fletën poseduese nr. 66 i cili konfirmon pronësinë e tij për pronat e kërkuara. Sekretaria Ekzekutive i ka verifikuar si fletën poseduese ashtu edhe vendimin e trashëgimisë.

39. Si paraqitësi i parë i kërkesës ashtu edhe paraqitësi i dytë i kërkesës konfirmojnë se ata kanë nënshkruar një transaksion me Behxhet Sadriun, vëllain e palës së parë përgjegjëse, në 2008 për shitjen e ngastrave të kërkuara. Megjithatë, ata deklarojnë se transaksioni nuk është finalizuar pasi pjesa përfundimtare e çmimit të blerjes nuk është paguar nga Bexhet Sadriu.

40. Pala e parë përgjegjëse deklaron se vëllai i tij Bexhet Sadriu nënshkroi një kontratë blerje me Zoran, Milutin dhe Mica Stevic më 4 janar 2008 për ngastrat e kërkuara me çmimin e blerjes prej € 250,000. Milutin dhe Mica janë nipi/mbesa e Dragoljub dhe kushërinjtë e paraqitësit të parë të kërkesës. Paraqitësja e parë e kërkesës konfirmon se ai i kishte dhënë lejen verbale Milutin-it dhe Mica-s që të shiste ngastrat e kërkuara në emër të saj. Pala e parë përgjegjëse deklaron se të gjithë shitësit ishin të pranishëm kur u nënshkrua kontrata dhe iu pagua atyre çmimi i blerjes prej € 200,000 në atë kohë. Pjesa tjetër e çmimit do të paguhej brenda gjashtë muajve në të cilën kohë 'trashëgimtarët' do të siguronin dokumentacionin e nevojshëm që konfirmonte pronësinë e pronës përmes trashëgimisë. Duket që procedura e trashëgimisë nuk ka përfunduar dhe pjesa e mbetur e çmimit nuk është paguar. Paraqitësi i dytë i kërkesës konfirmon se ai ka marrë pjesën më të madhe të çmimit të blerjes që i detyrohen atij dhe vetëm një shumë e vogël ka mbetur papaguar. Paraqitësi i parë i kërkesës konfirmon se atij i është paguar një shumë parash si pjesë e transaksionit të blerjes. Një kopje e kontratës së blerjes i është ofruar Sekretarisë Ekzekutive, por kontrata nuk është vërtetuar nga gjykata pasi procedura e trashëgimisë nuk është përfunduar.

41. Pala e dytë përgjegjëse pretendon se vëllai i tij Isa Hoti, është pronari i ngastrës nr. 728, e shënuar në fletën poseduese nr. 96, e cila është subjekt i kërkesës nr. 47740. Ai deklaron se gjysma tjetër e ngastrës i takonte Dragoljub Stevic. Ai deklaron se vëllai i tij e bleu pronën e kërkuar nga Milojka Korac në vitin 1987, por se vëllai nuk ka mundur ta regjistrojë blerjen në atë kohë për shkak të legjislacionit diskriminues i cili e ndalonte shtetasit e përkatësisë shqiptare të regjistronin blerjet e pronave të paluajtshme nga shtetasit e përkatësisë serbe. Ai pretendon gjithashtu se kontrata e blerjes është djegur gjatë luftës, por ka dëshmitarë që kanë qenë të pranishëm në transaksion të cilët mund të konfirmojnë shitjen. Paraqitësja e parë i kërkesës e ka konfirmuar këtë transaksion dhe deklaron se gjysma tjetër e ngastrës i takon gjyshit të saj Dragoljub Stevic.

42. Komisioni vëren se vetëm paraqitësi i dytë i kërkesës kishte zotësinë ligjore për të shitur pronat të cilat janë në emrin e tij. Të dy nënshkruesit e tjerë të kontratës, Milutin dhe Mica Stevic, të cilët pretendojnë të jenë trashëgimtarë të Dragoljub dhe Ratimir Stevic, asnjëherë nuk janë konfirmuar si trashëgimtarë me anë të ndonjë vendimi të vlefshëm të gjykatës dhe për rrjedhojë nuk kanë pasur zotësinë ligjore për të shitur pronat. Po ashtu as paraqitësi i parë i kërkesës nuk ka zotësinë ligjore të shesë pronat të cilat ajo pretendon se i ka trashëguar nga gjyshi i saj, pasi vendimi i trashëgimisë është lëshuar nga një gjykatë paralele.

43. Me qëllim që të përmbushen kriteret për konfirmimin e pronësisë nga Komisioni ashtu si përcaktohet me nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësit e kërkesave duhet të tregojnë së kërkesa ndërlihet me konfliktin në kuptimin se ajo përfshin rrethana që ndërlihen drejtpërsëdrejti apo janë si rezultat i konfliktit të 1998-99. Megjithatë kjo nuk është treguar as nga paraqitësi i parë apo i dytë i kërkesave. Po ashtu nuk është treguar se ka pasur humbje të posedimit apo pamundësi të ushtrimit të të drejtave pronësore që ndërlihen me konfliktin. Në të vërtetë, të dy paraqitësit e kërkesave kanë ushtruar, ose kanë synuar të ushtrojnë të drejtat pronësore për ngastrat e kërkuara. Paraqitësi i dytë i kërkesës, i ka shitur ngastrat me anë të kontratës së shitblerjes të vitit 2008 në cilësinë e bartësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i parë i kërkesës ka synuar t'ua shesë disa nga ngastrat e gjyshit uzurpuesve aktualë të pronave. Ndonëse Komisioni nuk e pranon që paraqitësi i parë i kërkesës ka trashëguar pronat e kërkuara nga bartësi i ndjerë i së drejtës pronësore, nuk ka dëshmi për ndonjë pengesë në ushtrimin e të drejtave pronësore; përndryshe, e vetmja pengesë duket të jetë

mungesa e përfundimit të procedurës së trashëgimisë që çon në paqartësi se kush janë trashëgimtarët me të drejta të plota të pronave dhe për rrjedhojë cilët persona posedojnë zotësinë ligjore për të shitur ngastrat. Bazuar në mungesën e dëshmive për humbjen e posedimit apo mos ushtrimin e te drejtave pronësore për pronat për shkak të konfliktit, kërkesat duhet të hidhen poshtë pasi bien jashtë juridiksionit të Komisionit.

5. *Kërkesa nr. 42422 dhe të tjerat.*

44. Të 32 kërkesat e identifikuara në pjesën F të listës së bashkangjitur këtij vendimi janë depozituar nga Amet Ajdari ("paraqitësi i kërkesës") në cilësinë e tij të anëtarit të bashkësisë familjare, pikërisht djalit të bartësit të ndjerë të së drejtës pronësore.

45. Në mbështetje të kërkesave të tij, paraqitësi i kërkesës ka dorëzuar dokumente të ndryshme që përfshijnë fletën poseduese dhe dy aktgjykime. Fleta poseduese, e cila është verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive, e tregon babain e palës përgjegjëse, Xhemo Ajdari, si bartësin e së drejtës pronësore. Pasi paraqitësi i kërkesës dhe pala përgjegjëse janë kushërinj, bartësi i regjistruar i së drejtës pronësore është xhaxhai/daja i paraqitësit të kërkesës. Paraqitësi i kërkesës pohon se babai i tij është pronar me të drejta të plota i ¼ pjesë ideale të ngastrave të kërkuara. Ai kërkon riposedimin e pronave, si edhe kompensimin për shfrytëzimin e ngastrave të kërkuara. Pala përgjegjëse është uzurpuesi aktual i ngastrave të kërkuara.

46. Kontesti midis palëve në këtë rast vazhdon prej një kohe të gjatë e shkon para konfliktit. Ajo ka të bëjë me një kontratë dhurimi kontestuese që nga viti 1964. Pala përgjegjëse pohon se babai i paraqitësit të kërkesës, Memis, hoqi dorë nga pjesa e tij për pronat e kërkuara në dobi të vëllait të tij, Xhemo, në vitin 1953 në këmbim të pagesës së kompensimit për fëmijët. Më tej, pala përgjegjëse pretendon se paraqitësi i kërkesës tregoi interes në ngastrat e kërkuara vetëm kur vizitoi fshatin për here të parë në vitin 1986, i pa pronat dhe pohoi se toka i takonte gjyshit të tij, i cili ishte bartësi fillestar i së drejtës pronësore. Më pas, në vitin 1989, paraqitësi i kërkesës, filloi procesin gjyqësor në lidhje me pronat e kërkuara.

47. Vendimi i parë i Gjykatës Komunale të Prizrenit, vendimi nr. 1181/89 i datës 3 nëntor 1989, anuloi kontratën e dhurimit dhe vendosi në dobi të babait të paraqitësit të kërkesës. Gjykata vërejti se procedura e trashëgimisë në lidhje me bartësin e ndjerë të së drejtës pronësore, nuk ishte iniciuar ende dhe deklaroi se palët nuk mund të nënshkruajnë kontratë dhurimi në lidhje me pronat të cilat ata nuk i kanë në pronësi.

48. Më pas, babai i palës përgjegjëse bëri ankesë ndaj vendimit të Gjykatës Komunale dhe Gjykata e Qarkut në aktgjykimin Gz. Br. 103/90 datë 26 shkurt 1990, e refuzoi ankesën si të pabazuar.

49. Nëna e paraqitësit të kërkesës u përpoq të iniciojë procedurën e trashëgimisë në Gjykatën Komunale të Prizrenit në vitin 1992 në lidhje me pronën e bashkëshortit të saj, megjithatë gjykata e refuzoi kërkesën si jashtë afatit. Janë bërë shume kundërshtime nga familja e paraqitësit të kërkesës ndaj vendimit të trashëgimisë të Gjykatës Komunale të Prizrenit të vitit 1992 në lidhje me procedurën e trashëgimisë, përfshirë ankesat në Gjykatën e Qarkut të Prizrenit dhe Gjykatën Supreme në Beograd e cila lëshoi vendimin Rev. 3253/93 datë 6 tetor 1993, e cili vërtetoi ankesën kundrejt Gjykatës së Qarkut në Prizren në lidhje me këtë çështje. Veprime të

mëtejme që kundërshtojnë vendimin që lidhet me procedurën e trashëgimisë u iniciuan më 1994 dhe 1998, dhe duket se procesi gjyqësor në këtë çështje vazhdon.

50. Zyrtarët kadastrale kanë informuar Sekretarinë Ekzekutive se pronat e kërkuara ishin regjistruar në emër të babait të palës përgjegjëse në vitin 1984, ndonëse ata nuk janë të sigurtë se mbi çfarë baze ishte regjistruar prona pasi librat përkatës të arkivës ishin djegur në zjarrin në zyrrat kadastrale në Prizren në vitin 2007.

51. Komisioni konstaton se kontesti pronësor në këto kërkesa është si rezultat i një kontesti familjar prej një kohë të gjatë dhe nuk ndërlidhet aspak me konfliktin në Kosovë të 1998-1999. Në të vërtetë paraqitësi i kërkesës nuk pohon që kontesti ndërlidhet me konfliktin. Vërehet se kontesti ka filluar mjaft kohë para konfliktit dhe ka vazhduar midis kontestuesve pas konfliktit. Paraqitësi i kërkesës deklaron se as ai edhe as babai i tij nuk kanë pasur kurrë posedimin e pronave të kërkuara dhe pajtohet se pronat janë shfrytëzuar vazhdimisht nga familja e palës përgjegjëse. Pala përgjegjëse konfirmon se familja e tij ka pasur posedimin e pandërprerë të pronave. Në këto rrethana, kërkesa duhet të hidhet poshtë pasi bie jashtë juridiksionit të Komisionit.

C. Kërkesa të refuzuara.

52. Në pajtim me nenin 8.6 i Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-07907/50 Komisionit mund të refuzojë ose hedhë poshtë një kërkesë në çfarëdo baze. Kërkesat mund të refuzohen nga Komisioni midis të tjerash edhe nëse paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, nuk kanë mundur të provojnë interesin për të drejtat pronësore ose të shfrytëzimit për pronat e kërkuara.

53. Në bazë të nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr 03/L-079, Komisioni ka kompetencë për të vendosur kërkesat për të drejtë pronësore ose të shfrytëzimit për pronën e paluajtshme. Në marrjen e vendimit, Komisioni mund të marrë në konsideratë çfarëdo provë të besueshme, të cilat ai i konsideron të rëndësishme për kërkesën, përfshirë dëshmitë e paraqitura nga ana e Sekretarisë Ekzekutive lidhur me besueshmërinë e të dhënave publike. (Neni 6.2 i Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079). Komisioni mund të kërkojë nga Sekretariati për të marrë më shumë informacion nga një palë, ose për të kryer hetime shtesë në lidhje me ndonjë kërkesë (neni 6,3 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079). Në marrjen e vendimeve, Komisioni mund të bazohet, por nuk është e detyruar nga rregullat e marrjes së dëshmive të aplikuara në gjykatat vendore në Kosovë (pika 6,1 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5, e miratuar me Ligjin nr 03/L-079).

54. Katërmbëdhjetë kërkesat e identifikuar në pjesën G të listës së këtij vendimi janë depozituar nga paraqitësja e kërkesës në cilësinë e anëtares së bashkësisë familjare, pikërisht e bija e bartësit të së drejtës pronësore. Ndonëse pronat e kërkuara janë aktualisht të regjistruara në emrin e ndërmarrjes në pronësi shoqërore të quajtur "SLOGA," paraqitësja e kërkesës pohon se babai i saj ka përfituar të drejtën pronësore për pronat përmes vendimit të lëshuar nga Komisioni për Kthimin e Tokës në vitin 1993.

55. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësja e kërkesës ka dorëzuar vendimin nr. 07-461-18 datë 14 gusht 1993, të lëshuar nga Komisioni për Kthimin e Tokës në Podujevë, i cili i njeh të

drejtat pronësore babait të paraqitëses së kërkesës për disa prona si rrjedhojë e shpronësimit të mëparshëm të tokës. Vendimi i Komisionit për Kthimin e Tokës nuk i kthen paraqitësit të kërkesës ngastrat fillestare që i janë shpronësuar, por ngastrat e tjera që do të përputhen afërsisht me sipërfaqen dhe kategorinë e tokës së marrë. Në këtë procedure, paraqitësja e kërkesës kërkon ngastrat e kthyer, jo ngastrat që fillimisht i janë shpronësuar. Paraqitësja e kërkesës ka dorëzuar gjithashtu dokumente të tjera të ndryshme, përfshirë një kopje të ankesës të vitit 1994 nga ndërmarrja në pronësi shoqërore 'PERPARIMI' dhe të tjerët drejtuar Ministrisë së Financave, Sektori i Çështjeve Pronësore, kundër vendimit të vitit 1992 të Komisionit për Kthimin e Tokës, një vendim të Ministrisë së Financave të Serbisë të datës 20 tetor 1995 që anulon vendimet e Komisionit për Kthimin e Tokës datë 24 shkurt 1992 dhe 14 gusht 1993, një aktgjykim i Gjykatës Supreme të Beogradit nr. U-7038/95 që vërteton ankesën dhe anulon vendimin e Ministrisë së Financave. Paraqitësja e kërkesës nuk ka dorëzuar në Sekretarinë Ekzekutive një kopje të vendimit të vitit 1992 të Komisionit për Kthimin e Tokës.

56. Paraqitësja e kërkesës pretendon se babai i saj ka jetuar në Podujevë deri në mars 1999 kur ai u largua për në Kragujevc në Serbi. Babai i paraqitëses së kërkesës vdiq më 2000. Paraqitësja e kërkesës informoi se pasi babai i saj ishte shumë i sëmurë në vitet 1990, bazuar në vendimin e Komisionit për kthimin e Tokës, përmes një avokati, iu bë një kërkesë autoriteteve kadastrale në Podujevë në shkurt 1999, për të regjistruar pronat në emër të babait të saj. Paraqitësja e kërkesës tha se nuk ka pasur arsye që pronat të mos regjistroheshin në emër të babait të saj, pasi ajo kishte dokumentacionin e kërkuar pronësor për të dëshmuar pronësinë. Megjithatë, që nga konflikti i 1998-1999, familja e kishte të pamundur të udhëtonte për arsye sigurie që të regjistronte pronat.

57. Dy janë palët përgjegjëse në këtë kërkesë. Pala e parë përgjegjëse është drejtori i 'PERPARIMIT'. Ai informoi se 'SLOGA' ishte ndarë në katër kooperativa që shumë kohë më parë dhe një nga organizatat ishte 'PERPARIMI'. Pala e parë përgjegjëse ka dorëzuar një numër dokumentesh përfshirë një fletë poseduese që konfirmon se ndërmarrja në pronësi shoqërore 'SLOGA' është bartësja e së drejtës pronësore të ngastrave të kërkuara. Ky dokument është verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive. Pala e parë përgjegjëse ka ofruar gjithashtu një deklaratë e cila thotë se 'PERPARIMI' ka qenë në posedim të vazhdueshëm të ngastrave të kërkuara për më tepër se 50 vite. Ai pohon gjithashtu se paraqitësi i kërkesës kërkon të drejtë pronësore bazuar në një vendim që është lëshuar në kohën e diskriminimit të gjerë ndaj shqiptarëve kur gjykatat serbe u kthenin pronat, pa asnjë bazë ligjore, personave të cilët më herët i kishin shitur pronat e tyre.

58. Pala e parë përgjegjëse, ka dorëzuar gjithashtu një deklaratë në emër të palës së dytë përgjegjëse, i cili ka kërkuar të drejtë ligjore në lidhje me kërkesat nr. 24354, 24674, 24680, 24681, 24685, 24688, 24689 dhe 24692. Pala e dytë përgjegjëse pohon se katër hektarë të tokës i takonin babait të tij deri në vitin 1952, kur toka u mor pa kompensim. Pala e dytë përgjegjëse pohoi se dokumentacioni mbështetës në lidhje me kërkesën e tij, është djegur gjatë luftës. Ai deklaroi gjithashtu se kishte depozituar ankesë në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, por nuk kishte marrë ende ndonjë përgjigje.

59. Në rrjedhën e shkëmbimit të dokumenteve, paraqitëses së kërkesës iu dha një kopje e fletës poseduese e cila konfirmonte se 'SLOGA' është aktualisht e regjistruar si pronar i të gjitha ngastrave të tokës me përjashtim të tri ngastrave të cilat janë transferuar nga 'SLOGA' në një organizatë të quajtur 'SHPRESA' me anë të vendimeve kadastrale të marra në vitet 2000 dhe 2001. Sekretaria Ekzekutive informoi gjithashtu paraqitësen e kërkesës se vendimi i vitit 1993 i

Komisionit për Kthimin e Tokës që ajo kishte ofruar, nuk mundi të verifikohet, pasi ai nuk përmban vulën e gjykatës që tregon se vendimi është i formës së prerë edhe i zbatueshëm. Paraqitësja e kërkesës u ftua të dorëzojë një kopje të vendimit me vulë, por ajo nuk e bëri këtë. Ajo informoi se vendimi me vulën e plotfuqishmërisë duhet të ndodhet në arkivat e zhvendosura në Serbi.

60. Sekretaria Ekzekutive u përpoq të verifikojë vendimin e Komisionit për Kthimin e Tokës me mënyra të ndryshme. Autoritetet kadastrale vendore informuan se vendimi nuk ishte ekzekutuar asnjëherë në regjistrat kadastralë dhe konfirmuan se prona mbetet e regjistruar si prone shoqërore. Më tej, ata informuan se nuk kishin asnjë shënim për kërkesë të bërë për regjistrimin e pronës në emër të babait të paraqitësit të kërkesës në shkurt 1999. Më tej, zyrtarët kadastralë theksuan se vendimi i Komisionit për Kthimin e Tokës nuk mund të konsiderohet i vlefshëm pa vulën që tregon se vendimi është i plotfuqishëm.

61. Sekretaria Ekzekutive u përpoq gjithashtu të verifikojë vendimin kundrejt regjistrave të mbajtur në Gjykatën Komunale të Podujevës, megjithatë vendimi nuk u gjet. U bënë gjithashtu përpjekje për të verifikuar vendimin në arkivat e zhvendosura në Krushevc, Serbi, megjithatë, vendimi nuk u gjend dhe Sekretaria Ekzekutive u informua se jo të gjitha regjistrat e zhvendosura nga Podujeva mbaheshin në arkivat e Kurshevcit.

62. Nga dokumentet e paraqitura nga paraqitësja e kërkesës, duket se vendimet e Komisionit për Kthimin e Tokës i vitit 1992 dhe 1993 kanë qenë subjekt i ankesave edhe kundërshtimeve. Ankesa e vitit 1994 nga 'PERPARIMI' dhe të tjerët në Ministrinë e Financave, Sektori i Çështjeve Pronësore, e kundërshtoi vendimin e Komisionit të vitit 1992 në baza të ndryshme. Me anë të vendimit të datës 30 tetor 1995, Ministria e Financave e Serbisë anuloi vendimin e Komisionit të vitit 1993 dhe ia ktheu çështjen organit të nivelit të parë për rivendosje. Babai i paraqitëses së kërkesës e kundërshtoi vendimin e Ministrisë së Financave në Gjykatën Supreme të Beogradit e cila e pranoi ankesën, anuloi vendimin e Ministrisë së Financave dhe e ktheu çështjen për rivendosje.

63. Nuk është e qartë nëse Ministria e Financave mori vendim tjetër në këtë çështje, edhe nëse është kështu, cili ishte rezultati i vendimit madje edhe nuk dihet nëse ai është ankimuar. Është e paqartë nga dokumentacioni i dorëzuar nga paraqitësja e kërkesës nëse kontesti ka përfunduar në dobi të paraqitëses së kërkesës. Vendimi i Komisionit për Kthimin e Tokës i ofruar nga paraqitësja e kërkesës nuk mundi të verifikohet në mungesë të konfirmimit të plotfuqishmërisë dhe paraqitësja e kërkesës nuk ka dorëzuar asnjë dëshmi tjetër për pronësinë e pronës. Në të kundërtën, pronat mbeten të regjistruara në emër të ndërmarrjes në pronësi shoqërore "SLOGA". Pasi paraqitësja e kërkesës nuk ka mundur të vërtetojë ekzistencën e së drejtës private pronësore për pronat në emër të babait, kërkesa duhet të refuzohet nga Komisioni.

D. Kërkesa për kompensim.


64. Në kërkesat e përmendura në kolonat përkatëse të pjesëve A, B, C dhe D të listës së bashkëngjitur, paraqitësit e kërkesave gjithashtu kërkojnë, përveç pronësisë, kompensim për dëmin material apo humbje të shfrytëzimit të pronës së kërkuar. Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni nuk ka juridiksion për kërkesat e tilla. Rrjedhimisht, ky aspekt i kërkesave për kompensim duhet të hidhet poshtë.

E. Vërejtje përmbledhëse.

65. Vendimi dhe urdhri i Komisionit zbatohen gjithashtu, kur është e mundur, për çfarëdo pronë të bashkuar, dmth ndërtesa ose ndërtime të tjera në pronësi apo shfrytëzim të paraqitësit të kërkesës ose bartësit të së drejtës pronësore, sipas rastit, të cilat formojnë një njësi pronën banesore të kërkuar.

66. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 i miratuar me Ligjin 03/L-079, lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuara në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo është e përshtatshme në këtë rast.

67. Vendimi i Komisionit nuk cenon të drejtat e paraqitësve të kërkesave ose bartësve të së drejtave pronësore, sipas rastit, për të kërkuar konfirmimin e të drejtave pronësore për pronat e kërkuara para autoriteteve kompetente vendore të tilla si autoriteteve kadastrale ose gjykatave vendore, në pajtim me ligjin në fuqi.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligji Nr. 03/L-079 parashohin që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo
- (b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

Informacione shtesë lidhur me procedurën e ankesave gjenden në Faqen e veçantë të Informacioneve për Ankesa e cila u ofrohet palëve së bashku me vendimin.

*** Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze.**

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part A/Pjesa A/Deo A

KPA15537						
KPA15536						

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part B/Pjesa B/Deo B

KPA16011	KPA16012	KPA16013	KPA16014	KPA90427	KPA90428	KPA90429
KPA90432	KPA90433	KPA90435	KPA90436			

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part C/Pjesa C/Deo C

KPA20163	KPA20164	KPA20165	KPA20166	KPA20167	KPA20168	KPA20169
----------	----------	----------	----------	----------	----------	----------

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part D/Pjesa D/Deo D

KPA23155	KPA47552	KPA47554	KPA47743	KPA47744	KPA49522	KPA49516
KPA49517	KPA47550	KPA47553	KPA47726	KPA47727	KPA47729	KPA47730

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part E/Pjesa E/Deo E

KPA34116	KPA27391	KPA27395	KPA27397	KPA34117	KPA34128	KPA34129
KPA27389	KPA27392	KPA34111	KPA34113	KPA34118	KPA34130	KPA34131
KPA34132	KPA34133	KPA34134				

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part F/Pjesa F/Deo F

KPA42422	KPA42423	KPA42424	KPA42426	KPA42429	KPA42432	KPA42433
KPA42434	KPA42438	KPA43338	KPA43339	KPA43347	KPA43350	KPA43351
KPA43353	KPA43354	KPA42425	KPA42427	KPA42428	KPA42430	KPA42435
KPA42436	KPA42437	KPA42439	KPA43337	KPA43340	KPA43341	KPA43342
KPA43348	KPA43349	KPA43352	KPA43355			

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part G/Pjesa G/Deo G

KPA24354	KPA24675	KPA24679	KPA24680	KPA24681	KPA24685	KPA24688
KPA24689	KPA24692	KPA24694	KPA24697	KPA24698	KPA24700	KPA24701